

Statistikat Afatshkurtra

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	7
5. Periudha e referencës	7
6. Mandati institucional.....	7
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	8
11. Manaxhimi i cilësisë	9
12. Rëndësia.....	10
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	11
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	12
17. Rishikimi i të dhënave.....	12
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komente.....	14
Aneks	14

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.3. Personi i kontaktit	Olsida Spiro (Çapo)
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ocapo@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	15.03.2019
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	20.06.2018
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	15.03.2019
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat Afatshkurtra (SASH) paraqesin një informacion shumë të rëndësishëm mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve të zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve dhe klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë. Ndryshoret (variablat) kryesore të kërkuar janë Shitjet neto (xhiro), Prodhimi Industrial, Prodhimi në ndërtim, Numri mesatar i të punësuarve, Fondi i pagave, Çmimet e Prodhimit, Çmimet e Importit, Kosto në Ndërtim. Të gjithë treguesit e prodhuar janë të shprehur në indekse, në ndryshim vjetor dhe në ndryshim tremujor. Ato prodhohen në periudha tremujore dhe vjetore me dhe pa përshtatje sezonale. Treguesit e prodhuar sipas sektorëve, janë si më poshtë:</p> <p>INDUSTRI</p> <p>Volumi i prodhimit</p> <p>Shitjet neto (xhiro): gjithsej, për tregun vendas dhe atë të huaj</p> <p>Çmimet e prodhimit: gjithsej, për tregun vendas dhe atë të huaj</p> <p>Çmimet e importit</p> <p>Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Numri mesatar i të punësuarve gjithsej o Numri mesatar i të punësuarve me pagesë o Fondi i pagave

	<p>NDËRTIM</p> <p>Volumi i ndërtimit</p> <p>Volumi i ndërtimit gjithsej ndahet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Ndërtime të reja o Rikonstruksione o Punime inxhinierike <p>Kushtimi në ndërtim</p> <p>Kostoja e materialeve</p> <p>Kostoja “shpenzime për pagë”</p> <p>Shitjet neto (xhiro)</p> <p>Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Numri mesatar i të punësuarve gjithsej o Numri mesatar i të punësuarve me pagesë o Fondi i pagave <p>TREGTIA ME PAKICË</p> <p>Shitjet neto (xhiro)</p> <p>Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Numri mesatar i të punësuarve gjithsej o Numri mesatar i të punësuarve me pagesë o Fondi i pagave <p>SHËRBIME TË TJERA</p> <p>Shitjet neto (xhiro);</p> <p>Treguesit e forcave të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Numri mesatar i të punësuarve gjithsej o Numri mesatar i të punësuarve me pagesë o Fondi i pagave
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Nomenklatura e përdorur për Statistikat Afatshkurtra është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, (NVE Rev.2).</p> <p>https://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=NACE_REV2&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=&StrLayoutCode=HIERARCHIC</p> <p>Klasifikimi Evropian i Produkteve sipas Aktiviteteve Versioni i 2008 (NP).</p> <p>https://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=CPA_2008&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=&StrLayoutCode=HIERARCHIC</p> <p>Ndarja e treguesve të ndërtimit në Ndërtesa të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike është bazuar në Klasifikimin e Ndërtimit (1998) (KN).</p> <p>https://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=CPA_2008&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=&StrLayoutCode=HIERARCHIC</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Statistikat afatshkurtra mbulojnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë aktivitet ekonomik në:</p> <p>1-INDUSTRI</p> <p>A-Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni B tek E të klasifikimit NVE Rev.2</p>

B – Industri Nxjerrëse mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 0509

C – Industri përpunuese mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 1033

D – Energji elektrike, gaz dhe avull mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 35

E – Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 36-39

Ndërsa treguesit e Çmimeve të Importit mbulojnë produktet e listuara nga seksioni B tek E lidhur me Klasifikimin Evropian të Produkteve sipas Aktiviteteve (NP).
http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=CPA_2008&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=&StrLayoutCode=HIERARCHIC

2-NDERTIMI

Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin F të klasifikimit NVE Rev.2.

F – Ndërtim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 41-43 Ndarja e treguesve të ndërtimit sipas Ndërtesa të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike është bazuar në Klasifikimin e Ndërtimit(1998) (KN).
https://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=CC_1998&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=&StrLayoutCode=HIERARCHIC

3-TREGËTIA ME PAKICË

Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në seksionin G të klasifikimit NVE Rev.2

G – Tregtia me pakicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 47.11 tek 47.78

4-SHËRBIME

Treguesit në këtë sektor mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara nga seksioni G tek N të klasifikimit NVE Rev.2

G – Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 45

G – Tregtia me shumicë mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 46

H – Transport dhe magazinim mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49 tek 53

- Transporti hekurudhor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49
- Transporti detar mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 50
- Transporti ajror mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 51
- Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 52
- Aktivitete të postës dhe korrierës mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 53

I – Hotele mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.00

J – Informacion dhe komunikacion mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58, 61, 62

- Aktivitete publikimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58
- Telekomunikacioni mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 61
- Shërbime të teknologjisë së informacionit mbulon aktivitetet ekonomike të

	<p>listuara në kodin 62</p> <p>M – Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 71</p> <p>N – Agjenci udhëtimi mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 79</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Prodhimi Objektivi i indeksit të prodhimit është të tregojë volumin e prodhimit në intervale të rregullta, kryesisht tremujore dhe vjetore. Ky indeks tregon ecurinë e volumit të vlerës së prodhimit gjatë periudhës referuese. Indeksi i prodhimit është një matje teorike që duhet saktësuar me matje praktike. Vlera e shtuar me faktorin kosto mund të llogaritet nga shifra e afarizmit (duke përjashtuar TVSH dhe taksa të tjera të zbritshme të lidhura direkt me shifrën e afarizmit), plus prodhimi i aktiveve të qëndrueshme, plus të ardhura të tjera operative plus ose minus gjendjen në stok (ndryshimi në gjendjen e prodhimit të vet), minus blerjet e mallrara dhe shërbimeve, minus taksa të tjera në produkte të cilat janë të lidhura me shifrën e afarizmit por jo të zbritshme, plus çdo subvencion mbi mallrat e marra.</p> <p>Shitjet neto (xhiro) Objektivi i indeksit të shitjeve neto është të tregojë zhvillimin e tregut të mallrave dhe të shërbimeve. Shitjet neto përfshijnë totalin e faturuar nga njësia e vëzhguar gjatë periudhës referuese dhe kjo korrespondon me shitjet e produkteve apo shërbimeve të shërbyera palëve të treta. Shitjet neto përfshijnë gjithashtu të gjitha ngarkesat e tjera (transporti, paketimi etj.) që i kalojnë konsumatorit, edhe pse këto ngarkesa janë të listuara apo të ndara në faturë. Shitjet neto përjashtojnë TVSH dhe taksa të tjera të ngjashme të lidhura direkt me shitjet neto si dhe të gjitha detyrimet dhe taksat mbi mallrat e faturuara nga njësia. Treguesit e shitjeve neto brenda dhe jashtë vendit kërkojnë që shitjet neto të ndahen sipas destinacionit të parë të produktit bazuar në ndryshimin e pronësisë. Destinacioni është vendosur nga vendodhja e palës së tretë të cilët kanë blerë mallra dhe shërbime. Treguesi mbi indeksin e shitjeve neto vendase dhe atë për eksport vetëm mblidhen por nuk publikohen.</p> <p>Volumi i shitjeve neto Volumi i shitjeve paraqet vlerën e shitjeve deflatuar me çmime konstante apo dhe me çmime aktuale përmes aplikimit të deflatorëve të shitjeve. Indeksi i çmimeve të prodhimit Indeksi i çmimeve të prodhimit mat ndryshimin në nivel prodhuesi të çmimeve të produkteve të prodhuara në vend me destinacion tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Indeksi i çmimeve të prodhimit për produktet e shitura në tregun vendas mat ndryshimet e çmimeve të produkteve të prodhuara dhe të shitura brenda vendit në një periudhë të dhënë kohe (tremujore). • Indeksi i çmimeve të eksportit mat ndryshimin e çmimeve të prodhimit për produktet e prodhuara në vend dhe të tregtuara jashtë vendit për një periudhë të dhënë kohe (tremujore). <p>Indeksi i çmimeve të importit Indeksi i çmimeve të importit mat ndryshimin në çmimet e importit. Import është çdo lloj produkti që nuk është prodhuar në Shqipëri, por që është importuar nga një vend tjetër.</p> <p>Numri mesatar i të punësuarve gjithsej</p>

	<p>Indeksi i numrit mesatar të personave të punësuar gjithsej ka si objektiv të tregojë zhvillimin e punësimit. Numri mesatar i të punësuarve gjithsej është përkufizuar si numri total i personave që punojnë në njësinë e vëzhguar (duke përfshirë pronarët që punojnë, partnerë që punojnë rregullisht në njësi dhe pjestarët e familjes që punojnë, por nuk paguhen), si dhe i personave që punojnë jashtë njësisë, por që i përkasin asaj dhe që paguhen nga ajo (psh. përfaqësuesit e shitjeve, personeli i shpërndarjes, skuadra e riparimit dhe e mirëmbajtjes).</p> <p>Numri mesatar i të punësuarve me pagesë Janë të gjithë personat që punojnë për llogari të punëdhënësit kundrejt një page për punën që kryejnë.</p> <p>Fondi pagave Indeksi i fondit të pagave ka për objektiv të tregojë ecurinë e kostove gjithsej të personelit. Pagat janë përkufizuar si shpërblimi total në monedhë ose në natyrë, të paguar të gjithë personave të shënuar në listën e pagave (duke përfshirë dhe ato që punojnë në shtëpi) si shpërblim i punës së bërë gjatë periudhës së llogarituar pavarësisht nëse është paguar në bazë të kohës së punës, prodhimit apo punës me pjesë dhe nëse është paguar rregullisht ose jo).</p> <p>Indeksi i Kushtimit në Ndërtim Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, fuqisë punëtore dhe shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate).</p> <p>Indeksi i Kostos së materialeve mat ecurinë e çmimeve të materialeve kryesore në ndërtimit. Ky grup është i ndarë në tre nëngrupe: materiale ndërtimi, materiale elektrike dhe komunikimi dhe materiale hidrosanitare.</p> <p>Indeksi “Shpenzime page” mat ecurinë e pagave për inxhinierët, teknikët dhe punëtorët e thjeshtë. Treguesit kryesor të lejeve të ndërtimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri gjithsej i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) • Sipërfaqja gjithsej në metra katrorë e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike • Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike sipas klientit <p>Lejet e ndërtimit: Numri i ndërtesave, Metra katrorë të sipërfaqes gjithsej</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës • Lejet e ndërtimit të miratuara parashikojnë ecurinë e sektorit të ndërtimit për periudhën pasardhëse bazuar në të dhënat kryesore të përfuara nga ky tregues • Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve <p>Sipërfaqja në metra katrorë është hapësira gjithsej ku vihet në zbatim projekti i miratuar.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.

3.6. Popullata statistikore	Popullsia statistikore përfshin njësitë statistikore, ndërmarrjet aktive në periudhën referuese, të cilat operojnë në aktivitetet ekonomike sipas NVE Rev.2, Industri (seksionet B, C,D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39); Ndërtim (seksioni F, ndarjet 41-43); Tregti (seksioni G, ndarjet 45-47); Shërbime (seksioni H, ndarjet 49-53; seksioni I, ndarja 55.1; seksioni J, ndarjet 58-63; seksioni M, ndarja 71; seksioni N, ndarja 79).
3.7. Zona e referencës	Statistikat Afatshkurtra mbulojnë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat afatshkurtra tremujore referuar indekseve të shitjeve, prodhimit, numrit të punësuarve, fondit të pagave datojnë prej vitit 2003 në vazhdim. Indeksi i shitjeve dhe volumit në Tregtinë me Pakicë dhe Indekset e Çmimeve të Prodhimit datojnë prej vitit 1999 në vazhdim. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim daton prej vitit 1993 në vazhdim. Indekset e Çmimeve të Importit janë publikuar për herë të parë në 2016 me seri kohore 2012-2016 (2012=100).
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2010 = 100
4. Njësia matëse	Njësitë matëse janë Indekset dhe Ndryshimet në përqindje.
5. Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar nga SASH i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2018.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore për prodhimin e treguesve të SASH është: Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2017-2021 http://www.instat.gov.al/media/3594/psz-2017-2021.pdf Rregullorja e Këshillit Evropian Nr. 1165/98 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A31998R1165 Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 1503/2006 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006R1503&from=EN
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nga tremujori i parë 2018 statistikat afatshkurtra transmetohen rregullisht në Eurostat për disa tregues kryesorë.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht.

	Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm .
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Instituti i statistikave (INSTAT) mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; b) njësia statistikore ka dhënë mirsatimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Rezultatet Finale publikohen 75 ditë pas fundit të vitit referencë (T+75 ditë). Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendarin e publikimeve mund të aksesohet online në linkun e mëposhtëm: http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendar/
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018, datë 17.04.2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> · Website – online release · Kërkesat e shkruara · Publikimet · Pjesa e Info-s e dedikuar për të kontaktuar INSTAT http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/kërko-të-dhëna/regjistrimi/
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Të dhëna tremujore në nivel vendi.
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për	Sipas Kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi

media	Statistikat Afatshkurtra. Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e Statistikave Afatshkurtra gjenden të botuara në publikimin e dedikuar dhe në Vjetarin Statistikor. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: Industria, Tregtia dhe Shërbimet, Statistikat afatshkurtra (publikim i dedikuar): http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhesh%C3%ABrbimet/statistikat-afatshkurtra/ Vjetari Statistikor: http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e SASH. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e SASH nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun më poshtë: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/kërko-të-dhëna/kërkesë-të-dhënash-formulari/
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin në linkun e mëposhtëm: http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/statistikat-afatshkurtra/#tab4
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "Për statistikat Zyrtare", Nr.17/2018, datë 17.04.2018", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për

	sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e SASH krahasohen me të dhënat e SASH në vitet e para për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e SASH-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë: <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e SASH -së si input në punën e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve • Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Page Views (Klikime) në lidhje me Statistikat Afatshkurtra për vitin 2018 janë rreth 6,151 klikime. Ndërkohë që në vitin 2017 ishin rreth 2,597 klikime. INSTAT gjatë vitit 2018 ka realizuar Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave për fushën Informacioni Ekonomik për Ndërmarrjet?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3, 55(71.0%). Më poshtë gjeni linkun e rezultateve të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. http://www.instat.gov.al/media/2974/anketa-mbi-kenaqesine-e-perdoruesve.pdf
12.3. Plotshmëria	Statistikat afatshkurtra janë ndërtuar në përputhshmëri me rregulloren e Eurostatit në numër variablash por niveli i plotshmërisë për Statistikat afatshkurtra për vitin 2018 të treguesve të prodhuar është 70.6%.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion.

13.2. Gabim i kampionimit	Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrotim llogaritet varianca e totalit, e cila estimohet me shumën sipas gjithë shtresave të variancës së totalit të shtresës si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.Devijimi standart relativ mesatar për variablin shitje neto është mesatarisht 3.57%.
13.3. Gabim jo i kampionimit	<u>Mos-përgjigja në nivel rekordi</u> merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi për SASH 2018 mesatarisht është 5.08 %. <u>Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli</u> për variablat kryesorë të SASH janë: Numri i mesatar i të punësuarve gjithsej është 5.59%, ndërsa për Shitjet neto gjithsej është 5.67%.
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	Indekset e Statistikave Afatshkurtra publikohen afërsisht 75 pas përfundimit të tremujorit. Ky raport cilësie i referohet rezultateve të vitit 2018.
14.2. Përpikmëria	Të dhënat finale të SASH, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve, i cili publikohet në faqen e internetit të INSTAT çdo vit. Publikimi i SASH, ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikime të kryera gjatë viteve.
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi treguesit e SASH janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Ndër vite Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve në SASH ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. ATN ka filluar për herë të parë në vitin 2003. Në vitin 2005 është shtuar aktiviteti i Tregtisë me shumicë. Në vitin 2008 metoda e kampionimit kalon nga metoda me listim në metodën e kombinuar (me kampionim dhe listim).Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia e ATN si rezultat i përditësimit të Rregjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Në vitin 2014 në SASH implementohet Nomenklatura e Re e Aktiviteteve Ekonomike, NVE REv.2, përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2005 në 2010. Në të gjitha këto ndryshime seritë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë përditësuar për të reflektuar ndryshimet. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në Shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Të dhënat kontrollohen me burimet administrative me bazë tremujore. Pas këtyre kontrolleve mund të konkludohet se të dhënat janë koherente.
15.4. Koherenca e brendshme	Statisikat afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar përputhshmëri dhe koherencë të treguesve statistikor.

<p>16. Kostoja dhe ngarkesa</p>	<p>Kosto e SASH përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm.</p> <p>Numri i stafit të SASH: Gjithsej 249 të punësuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 7 të punësuar • Specialistë logjistike 2 të punësuar • Anketues (4 muaj) 220 të punësuar • Kontrollorë (4 muaj) 10 të punësuar • Operatorë (4 muaj) 10 të punësuar <p>Anketuesit punësohen katër herë në vit për anketat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve; 2. Anketa e Çmimeve të Prodhimit; 3. Anketa e Çmimeve të Importit; 4. Anketa e Kushtimit në Ndërtim. <p>Për trajtimin e mos përgjigjes përdoren të dhënat administrative për imputim të cilat janë falas. Marrëveshje e Bashkëpunimi janë nënshkruar midis INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në mënyrë që transmetimi i të dhënave administrative të mundësohet pa kosto. Burimet Statistike si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, etj) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brëndshëm. Stafi i SASH menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy proçese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit të ATN bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf http://www.instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf.</p> <p>E njëjta politikë rishikimi aplikohet edhe për dërgimin e të dhënave ne Eurostat.</p>
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Kur të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare atëherë këto të dhëna rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve ose ndryshimeve metodologjike. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat mbi SASH bazohen në: Vrojtime tremujore statistikore si ATN, IÇP, IÇI, IKN si dhe në burim administrativ: Lejet ndërtimit. Mjetet kryesore për përzgjedhje janë: Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve dhe Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.2. Popullsia përcaktohet sipas dy kritereve 14 bazë: Madhësisë së ndërmarrjeve sipas Numrit të të punësuarve dhe Aktivitetit Ekonomik Metoda e zgjedhjes së përdorur është Stratified Simple Random Sampling (SRS) (me prerje - cut-off). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e grup aktivitetit ekonomik me madhësinë e ndërmarrjes. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike sipas fushave të caktuara në rregulloren e SASH dhe</p>

	mbështetur edhe në nevojat e përdoruesve.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat grumbullohen me intervistim të drejtpërdrejtë me pyetësor me letër çdo tremujor, 15 ditë pas mbylljes së tremujorit referues. Kohëzgjatja në terren është 15 ditë pune.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënat e marra nga anketimi dhe nga skedari i TVSH-së vërtetohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave nga anketuesit me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Editimi përfshin kontrollë për plotsueshmerinë, nëse vlerat që janë brenda fushës së mbulimit dhe nëse vlerat e variablave të cilat kanë lidhje janë korrente. Editimi i të dhënave mund të bëhet përgjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen dhe me përgjigjet e tremujorëve pararendës. Paqëndrueshmeria ose devijime të mëdha (jashtë fushës së mbulimit të para përcaktuar) tregon që një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Nga pikëpamja e afatit kohor, procesi i editimit mund të dizenohet në mënyrë që tu japë prioritet atyre outliers që kanë më tepër nevojë për korrigjim për hir të agregatëve të besueshëm. Duke zgjedhur rastet më të këqija, përmirësime të mëdha mund të arrihen.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Pika e fillimit të procesit është informacioni direkt i mbledhur nga anketuesit. Qëllimi është për të sjellë këto të dhëna në nivelin e synuar statistikor. Hapat e punës mund të përmbliidhen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli fizik i pyetsorëve (verifikimi i plotësimit të pyetsorëve sipas standarteve të skanimit) • Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave) • Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë editimit. • Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit duhet të plotësohen me imputim. • Krahasueshmëria e të dhënave ndërmjet të dhënave të grumbulluara nga pyetsorët dhe të dhënave administrative • Editimi i shifrave duke marrë në konsideratë do ndërmarrje në nivel mikro sipas historikut të saj, apo aspekte të tjera dalluese si aktiviteti etj. • Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit • Të dhënat e agreguara mund të krahasohen me të dhëna nga burime të tjera dhe ndoshta të përfshira • Dy fazat e fundit mund t'i nënshtrohen edhe fazave të tjera të ndërmjetme analizash sipas fushave të publikimit Së fundi, kur përpilimi dhe analiza

	statistikore përfundon, ato rezultojnë si një grup të dhënash jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është dhe trajtimi i është së konfidencialitetit.
18.6. Rregullimi	Pjesa më e madhe e indekseve të SASH janë të rregulluara sezonalisht. Indekset e çmimeve, jepen vetëm në formë të parregulluar sezonalisht.
19. Komete	
Aneks	